



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:236893  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05728843

**Ac.nr.4787/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H. H. nga fshati S., Komuna Vushtrri, të cilin me autorizim e përfaqëson R. M., avokat nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria për Arsim, të cilën e përfaqëson I. G., për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe të përcjelljes në pension, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.511/2018, të datës 08.06.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria për Arsim, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.511/2018, datë 08.06.2021, në pikën I (një) të dispozitivit, në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësit përkitazi me kompensimin e shpërblimit jubilar, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit H. H. nga fshati S., Komuna Vushtrri, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria për Arsim, që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar t’ia kompensojë shumën prej 1,060.93 €.
- II. APROVOHET** pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria për Arsim, NDRYSHOHET Aktgjykimit i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,

C.nr.511/2018, të datës 08.06.2021, në pikën I (një) të dispozitivit, në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësit përkitazi me kompensimin e pagave përcjellëse, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: **APROVOHET** pjesërisht kërkesëpadia e paditësit H. H. nga fshati S., Komuna Vushtrri, **DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria për Arsim, që paditësit për dy paga përcjellëse për pension t'ia paguajë shumën prej 1,149,46€, me kamatë ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data 12.06.2017 deri në pagesën definitive.

**III.** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.511/2018, datë 08.06.2021, në pikën II (dy) të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.511/2018, të datës 08.06.2021, ka vendosur si në vijim: “I. **DETYROHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria Komunale e Arsimit që ne emër te pagesës se 3 pagave te shpërblimit jubilar për përvojën e tij mbi 40 vjeçare dhe dy pagave përcjellëse për ne pension, paditësit H. H. nga fshati S.-Vushtrri t'ia paguajë shumën totale prej 2,210.39 euro (dymijë e dyqind e dhjetë euro e tridhjetë e nëntë cent), me kamate ligjore prej 8% vjetore, që nga data e ushtrimit të padisë, dt:12.06.2017, e gjer ne përmbushjen definitive te detyrimit. II.**OBLIGOHET** e paditura Komuna e Vushtrrisë Drejtoria për Arsim që ne emër te shpenzimeve gjyqësore, paditësit t'ia paguajë 549 euro dhe atë shpenzimet gjyqësore sipas numrit C.nr.255/17, shumën prej 400 euro, si dhe ne emër te përfaqësimit për një seancë gjyqësore ne procedure rigjykuese nga I autorizuari i tij shumën prej 135 euro, te gjitha këto ne afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nen paralajmërimin e përmbartimit te detyrueshëm.”

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen ta vendos në mënyrë meritore si dhe ta ngarkojë paditësin me shpenzimet e procedurë.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës, me propozim që ankesa e të njëjtës të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet. Ka kërkuar që në emër të përpilimit për përgjigje në ankesë, e paditura t'ia paguajë shumën në vlerë prej 208,00 €.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi H. H. nga fshati S., Komuna Vushtrri, me datë 12.06.2017, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, ka ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria Komunale për Arsim, me objekt kontesti kompensim i pagave jubilarë dhe përcjellëse me pretendimet se i njëjti ka punuar si profesor i gjuhës angleze dhe zv. drejtor pranë të paditurës deri në kohën e pensionimit andaj në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura është e obliguar që paditëses t'ia kompensojë shumat e propozuara si në padi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.511/2018, të datës 08.06.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata ka theksuar se “.. nuk është kontestues fakti se pozita e Zëvendës Drejtorit hyn në kuadër të shërbimit civil të Kosovës, për faktin se me katalogun e hartuar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Administratës Publike i pasuar sipas vendimit të Ministrit të kësaj ministrie nr. 09 dt. 21.02.2018, në faqen 13 të këtij katalogu sipas numrit rendor 278, pozita e Drejtorit të Shkollës së Mesme dhe Zëvendës Drejtorit renditet si pozite që hynë në kategorinë e pozitave të shërbimit civil, mirëpo, referuar kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (KPM) nr. 06/L - 048, nenit 6, par.1, nën par.1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni ku përcaktohen funksionet e Këshillit në mes tjerash parashihen “ Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:, shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil; mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil; monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë, ndërsa lidhur me kompetencat e këshillit të përcaktuara me nenin 7 par.1 nën par si dhe nenin 1.1 deri në 1.6 të këtij ligji.

Më tutje ka theksuar se gjykata nisur nga kjo referuar të lartcekurave gjeti se KPM ka kompetencë vetëm sa i përket procedurës së rekrutimit në shërbimin civil, përveç kompetencave tjera të lartë cituara, porse, jo edhe kompensimin material të pagave apo beneficioneve tjera që dalin nga Ligji për Shërbimin Civil apo akte tjera nënligjore që rregullojnë fushën e shërbyesve civil ngase, kjo kompetencë gjyqësore i takon gjykatës, ashtu që, referuar edhe nenit 2, par.2.3 të Ligjit për Procedure Kontestimore në të cilin përcaktohet “Gjykata nuk mund të refuzojë shqyrtimin dhe vendosjen mbi kërkesat që janë në kompetencën e saj”, në lidhje me nenin 18, par.1 të të njëjtit ligj, ku parashihet “Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jonë kompetencën gjyqësore”, gjykata mbi bazën e kësaj gjeti se pretendimet e përfaqësuesit të të

paditurës sa i përket mungesës së kompetencës gjyqësore të kësaj gjykate për vendosje për kërkesëpadinë e paditësit H. H. janë të pazbatueshme.

Për vlerësimin e themelësisë së kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave nga neni 4, par.1, 52, par.1, nën par.1.1 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive lidhur me nenin 2 të LPK-së. Vendimin mbi kamatën gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës sepse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare, qoftë për themelësinë e kërkesëpadisë por edhe lartësinë e saj, ku në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse pjesa e ndryshuar e aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka paracaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për kompensimin e pagave përcjellëse për në pension dhe për shpërblim jubilar në atë mënyrë që përfundimi meritor është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar pjesët si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, ngase Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara, ngase nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka punuar tek e paditura si zëvendës drejtor në gjimnazin “E. Ç.” në Vushtrri, kjo sipas Vendimit Nr.844, të datës 24.09.2013 dhe kontratës së fundit të punës me nr. protokolli 975/13, të datës 10.09.2013

ndërsa po në këtë shkollë para se të zgjidhej zv. drejtor ka punuar si profesor i gjuhës frënge nga data 01.09.1971 e deri më datë 22.03.2016, e kjo sipas vërtetimit Nr.89, datë 08.02.2017.

Mirëpo në këtë rast, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e cila ka hyrë në fuqi nga 01.01.2015, përkatësisht me nenin 52 *“I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë”*.....1.2 *“për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij;”*.. Ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni parasheh *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Kjo dispozitë përcakton të drejtën e punëtorit për shpërblim jubilar, mirëpo në rastin konkret themelësia e kësaj pjese të kërkesëpadisë nuk ka mundur të mbështetet në këtë dispozitë për shkak se në rastin konkret paditësit e drejta për të kërkuar kompensimin e pagës jubilarë nga e paditura për 40 vite të përvojës së punës i ka takuar në vitin 2011, e kjo sipas Vërtetimit me nr.89, të datës 08.02.2017, lëshuar nga e paditura gjimnazi “E. Ç.” në Vushtri, nga i cili vërtetim rezulton se paditësi ka lidhur marrëdhënie pune me të paditurën që nga viti 1971, mirëpo në periudhën kur paditësi e ka mbushur jubileun, përkatësisht jubileun e katërdhjetë në vitin 2011, nuk ka pasur kontratë kolektive në fuqi, andaj nuk ka bazë ligjore për të kërkuar kompensim, pra në rastin konkret nuk është me rëndësi shumë periudha kur është kërkuar pasi çështje paraprake është se a ka pasur në fuqi kontratë kolektive në kohën e përmbushjes së kushtit për kompensim të pagës jubilarë. Meqenëse në vitin 2011 në kohën kur paditësi i ka mbushur vitet jubilarë, ka munguar baza ligjore, kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata vendosi që të ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në rastin konkret edhe sikur të ekzistonte baza ligjore për të kërkuar kompensim, pra sikur të kishte qenë në fuqi kontrata kolektive në vitin 2011, vit kur paditësi e ka plotësuar kushtin pra përmbushja e jubileut, nga ajo kohë e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar më tepër se 3 vite sikurse përcaktohet me nenin 87 të Ligjit të Punës dhe padia e tillë është e paraqitur pas afatit ligjor. Prandaj gjykata ankimore duke vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, me referim në dispozitën e nenit 195, paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201, paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi që aktgjykimin në pjesën përkatëse ta ndryshoj me refuzimin e kërkesëpadisë.*

Gjykata e Apelit, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe pjesërisht e ndryshoi këtë pikë të aktgjyimit, pasi që vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dy pagave për përcjellje në pension, në shumën prej 1,149,46 €, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale dhe me të drejtë është bazuar në dispozitën e nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës *“I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit”*, kjo pasi që referuar shkresave të lëndës e paditura paditësit ia kishte kompensuar një pagë për përcjellje në pension dhe kjo sipas Vendimit nr.138/16, të datës 03.03.2016, në lartësi prej 649,61 €. Lartësia e pagave për përcjellje në pension paditësit iu njoh në bazë të listës së pagave bashkangjitur në shkresa të lëndës nga e cila shihet se paga bruto e paditësit ishte në lartësi prej 649,61 € derisa paga neto 574,73 € ndërsa paga për përcjellje në pension sipas dispozitës së lartëcekur kompensohet në

pagë që paditësi e ka marr për tre muajt e fundit e që i bie paga neto në vlerë prej 574,73 € (për dy paga përcjellëse për pension, shumën prej 1,149,46 €).

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se paditësi është pensionuar tek e paditura me statusin e shërbyesit civil mirëpo sipas Mendimit Juridik lidhur me Ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publik: drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme si dhe kompetencën lëndorë të gjykatës 421/2023, të datës 27.02.2023, në fq.1, pika II, pasuesi 2 është sqaruar se “ *drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe sekretarët të shkollave fillore dhe të mesme, janë nëpunës të shërbimit publik, në kontestet e marrëdhënies së punës për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publik zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës , përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë dhe gjykohen sipas rregullave të procedurës kontestimore*”.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 450 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditëses për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, me referim në dispozitën e nenit 195, paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201 paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.4787/2021, më datë 23.05.2024.**

**Kryetari i kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**